



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:080537  
Datë: 04.06.2024  
Numri i dokumentit: 05775013

**Kom.Dh.Shk.II.nr.117/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESCO), me seli në Prishtinë, kundër debitorit D.P.H. Payton -M.H., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.371/23 të datës 12.05.2023, me datë 04.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESCO), ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.371/23 të datës 12.05.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.371/23 të datës 12.05.2023, më pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi e debitorit D.P.H. Payton -M.H., me seli në Prishtinë dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr.503/17 i datës 12.10.2017, i Përmbaruesit Privat Ilir Z. Mullhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 1,046.45 €. Në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit D.P.H. Payton -M.H., me seli në Prishtinë dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr.503/17 i datës 12.10.2017, i Përmbaruesit Privat Ilir Z. Mullhaxha, sa i përket shumës prej 198.11 € së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%. Ndërsa në pikën

III e ka përfunduar pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESco), ndaj debitorit, sipas urdhërit përbarimor P.nr.503/17 i datës 12.10.2017, për shumën prej 1,046.45 €.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESCO), pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.371/23 të datës 12.05.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, duke e lënë në fuqi Urdhrin për Përbarim P.nr.503/17 i datës 12.10.2017 si dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.371/23 të datës 12.05.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtuar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESCO), me datën 12.10.20217 ka paraqitur propozim për lejimin e përbarimit, kundër debitorit D.P.H. Payton -M.H., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Kartelen e klientit - Ekstrakti të verifikuar në librat afarist- me DPR-... për periudhën kohore 05.10.2013 deri 14.09.2017, në shumë prej 1,244.56 €.

Përbaruesi Privat Ilir Z. Mullhaxha, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESCO), ka caktuar urdhrin P.nr.503/17 i datës 12.10.2017, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelen e klientit - Ekstrakti të verifikuar në librat afarist- me DPR-... për periudhën kohore 05.10.2013 deri 14.09.2017, me të cilat i ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar shumën prej 1,244.56 €, me kamat ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja

e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbartimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.371/23 të datës 12.05.2023, më pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit D.P.H. Payton -M.H., me seli në Prishtinë dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.503/17 i datës 12.10.2017, i Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mullhaxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 1,046.45 € . Në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit D.P.H. Payton -M.H., me seli në Prishtinë dhe ka anuluar pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.503/17 i datës 12.10.2017, i Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mullhaxha, sa i përket shumës prej 198.11 € së bashku me kumatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%. Ndërsa në pikën III e ka përfunduar pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESco), ndaj debitorit, sipas urdhërit përmbartimor P.nr.503/17 i datës 12.10.2017, për shumën prej 1,046.45 €.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në bazë të shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në prapësim dhe përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave dhe vërejtjeve të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë ma aktvendim Kom.Dh.Shk.II. nr. 1299/22 të datës 15.02.2023, në pikë I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit si të bazuar, në rastin konkret Kartelen e klientit - Ekstrakti të verifikuar në librat afarist- me DPR-... për periudhën kohore 05.10.2013 deri 14.09.2017, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, me dispozitën e nenin 355 par.1 të LMD-së përcaktohet se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*, ndërsa ne par. 2 *“Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*. Pasi që kemi të bëjmë me faturime periodike mujore për shërbime të ofruara nga kreditori dhe për borxhin e faturuar në afatin 3 vjeçar paraprakisht parashtrimit të propozimit për përmbartim, gjegjësisht nga data 05.10.2013 deri me datën 01.09.2014 në shumë prej

1,046.45euro, është parashkruar, pasi që propozimi për përmbarrim është iniciuar me datën 12.07.2017, rrjedhimisht kanë kaluar më tepër se 3 vite nga koha e maturimit/arritjes për pagesë, cak i bie se kërkesa e kreditorit është parashkruar pasi që është paraqitur me propozim për përmbarrim më vonës dhe është vendosur si në pikën I të dispozitivit. Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar kërkesën e kreditorit dhe e ka lënë në fuqi urdhërin përmbarrimor në shumë prej 198,11 euro për periudhën 02.10.2014 deri me 14.09.2017, pasi që borxhi për këtë periudhë nuk është parashkruar, sepse me datën 12.10.2017 kreditorit ka ushtruar propozimin për përmbarrim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të LMD-së përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*. Në pikën III të dispozitivit e ka përfunduar pjesërisht procedurën e përmbarrimit nisur nga fakti se gjykat duke u bazuar në nenin 12 para.1 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshim dhe Plotësim e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, me cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimi, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarrim në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore me rastin e vendosjes në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimi e debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se kemi të bëjmë me parashkrim të faturave nga urdhëri përmbarrimor P.nr.503/17 i datës 12.10.2017 në lartësi prej 1,046.45euro, për periudhën 05.10.2013 deri me datën 01.09.2014. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 355 par.1 i LMD-së, i cili përcakton se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si*

*dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite” dhe paragrafin 2 të këtij neni përcakton se “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”. Sa i përket periudhës si në pikën II, prej datës 02.10.2014 deri me 14.09.2017, në shumë prej 198.11 euro, nuk kemi parashkrim dhe debitori ka drejt kamatë prej 8%, për vonesë lidhur me këtë shumë pasi që fatura janë bërë të arritshme për pagesë deri në pagesën definitive, duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së ku përcakton se: “debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”. Në pikën III të dispozitivit e ka përfunduar pjesërisht procedurën e përmbartimit, duke u bazuar në nenin 12 para.1 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshim dhe Plotësim e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me cilin përcaktohet se: “Në rast se e aprovon prapësimi, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartim në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera” dhe ky aktvendim ka hyrë në fuqi menjëherë.*

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se ekstrakti si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Mirëpo në rastin konkret qartë rezulton se nga ekstrakti për periudhën e lartëcekur, faturat që janë përshkruar si në urdhërin përmbartimore. Meqenëse ekstrakti financiar i paraqitur si dokument i besueshëm është paraqitur në tërësi nga viti 2013 deri vitin 2017 pra sipas nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbartues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues dhe/apo atij të besueshëm, me ç’rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv. Fakti se kreditori ka dorëzuar ekstraktin që janë faturat përmes këtij urdhëri përmbartimor është evidente, mirëpo këto faturime janë sipas periudhave mujore nga shërbimet e ofruara nga kreditori, pjesa e borxhit të mbetur sipas periudhave të lartëcekura 05.10.2013 deri me datën 01.09.2014 në shumë prej 1,046.45euro, janë përshkruar dhe në gjykat nuk mundë të konsiderohet i rregullt dhe nuk

nënkupton se mund të anashkalohe prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 355 par.1 dhe par. 2 të LMD-së, ndërsa pas viti 2014 deri me 2017, në shumë prej 198.11 euro, nuk kemi borxh të parashkruar si në dispozitiv të aktvendimit të gjykatës shkallës së parë.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.117/24 dt. 04.06.2024**

**Gjyqtarja,**  
**Saranda Bogaj -Sheremeti**